

# AKTI I THEMELIMIT

## SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “Wakesky” shpk

**Jian Sun** , i biri i Xingzheng, i datelindjes **10-11-1989** , i lindur ne Zhenjang dhe banuese ne Room 105, No. 37 Siyi Road, Shangcheng District, Hangzhou City , Zhejiang Province e Kines shtetase Kinez i identifikuar me ID dokumenti: EH9584732, numer personal: 1811702650

ne vijim do te quhet **“Ortak”**.

**Shengli Liu** , e bija e Ziqing , e datelindjes **07-05-1982** , e lindur ne Shaanxi dhe banuese ne Shuanghe Community, Group 3, Shuanghe Town, Xunyang County, Shaanxi Province e Kines shtetase Kineze e identifikuar me ID dokumenti EP0440250 dhe me numer personal 158861135X  
ne vijim do te quhet **“Ortak”**.

Sot me date **13-02-2025**, vendosem te themelojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“Wakesky” shpk** ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.



#### Kreu I

#### **OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

##### **Neni 1.Objekti i shoqerise**

##### **1.1.Shoqeria ka kete objekt veprimtarie;**

- Shoqeria organizon ture te ndryshme , turizem kulturor, turizem bujqesor dhe mbjellje, kampe dhe mallra sportive ne natyre, tregti e importit, prodhim motoçikletash elektrike dhe biçikletash elektrike, perpunim dhe dhënie me qira dhe tregti importi, tregti me qira makinash dhe pjesë auto, restorante dhe hotele, tregti produkteve shëndetësore dhe të kujdesit shëndetësor, tregti të aksesorëve të telefonave celularë dhe produkteve të vogla elektronike, import dhe eksport tregtisë ndërkombëtare, dyqane interneti, tregti elektronike
- Shoqeria organizon ture te ndryshme te permasave te ndryshme ne pjesemarrje, objektiv udhetimi, qellime udhetimi. etj, te ndryshme, brenda dhe jashte vendit, ne perputhje me legjislacionin e RSH dhe ate nderkombetar.
- Shoqeria do te kryeje aktivitet ne fushen e promovimit te turizmit vendas e te huaj,



bashkepunim me agjenci, persona juridike, fizike, individe, institucione te ndryshme shteterore / publike / private, etj;

- Organizim turesh brenda dhe jashte vendit. Shoqeria bashkepunon me agjenci te tjera turistike, udhetimi, shoqeri transportesh etj, vendase dhe / apo te huaja, hotele, resorte, restorante, individe, familje etj,

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj,

## **Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise**

2.1. Ortaket e shoqerise vendosen qe shoqerine ta emertoje

### **“Wakesky” shpk**

2.2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne : KAVAJE, Lagjja nr.1, Bulevardi "Josif Budo" ndertese 5-kateshe, kati i pare .

2.3. Shoqeria mund te krijoj qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

## **Neni.3.**

### **Regjimi Juridik**

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi

3.2. Me vendim te tyre Ortaket e shoqerise mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ne perputhje me ligjin

3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

## **Kreu II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

#### **Neni 4**

##### **Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve**

**4.1.** Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj .

**4.2.** Shoqeria gezon te drejten te krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

**4.3.** Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortakë ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

**4.4.** Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.

**4.5.** Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj

**4.6.** Ortaket kane te drejte te beje propozime, si dhe emeroje e shkarkoje, administratorin ose administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel, apo likujdatoret.

#### **Neni 5**

##### **Kohezgjatja**

**5.1.** Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar

### **Kreu III**

#### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

##### **Neni 6**

**6.1.** Kapitali themeltar eshte **100.000** (njqindemije) leke dhe eshte i ndare Ne 2 kuota

**6.2.** Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte :

**Jian Xingzheng Sun , 1 kuote me vlere 55.000 leke perkatesisht 55 % te kuotave te shoqerise.**

**Shengli Ziqing Liu , 1 kuote me vlere 45.000 leke perkatesisht 45 % te kuotave te shoqerise.**

### **Kreu IV**

#### **ORGANET E SHOQERISE**

##### **Neni 7**

**7.1.** Vendimet ne Shoqeri merren nga Ortaket ne Asamblene e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise dhe eksperti kontabel i autorizuar caktohen nga Ortaket e shoqerise .



**Kreu V**  
**ADMINISTRIMI**

**Neni 8**

**8.1.**Administrimi i shoqerise do te behet nga **Administratori** i saj zj. **Jian Xingzheng Sun.**

**8.2.**Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 ( pese) vjet me te drejte riperteritje ne perfundim te mandatit

**Kreu VI**  
**DISPOZITA TE TJERA**

**Neni 9**

**9.1.** Fitimi i realizuar nga Shoqeria , mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore do t'i mbetet Ortakeve te shoqerise ne raportet e zoterimit te kuotave te kapitalit.

**9.2.**Ky Akt shtypet dh efirmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore .Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise .

**ORTAKET E SHOQERISE “Wakesky” shpk**

**Jian SUN**

*Jian Sun*  


**Shengli LIU**

*shengli liu*  
